Ne autorizojmë autoritetin kontraktor të verifikojë informacionin e dhënë në këtë tabelë.

**PERSONI I KONTAKTIT (për këtë ofertë)**

**Emri:**

**Adresa:**

**Nr. Telefonit:**

**Faks:**

**E-mail:**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik)

### DEKLARATË MBI KONTRATAT E LIDHURA DHE/ OSE NE PROÇES<sup>4</sup>

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj se kam në proçes dhe/ose jam shpallur fitues për kontratat e mëposhtme:

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës se prokurimi/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Përfaqësuesi i ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shënim:** Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të plotësojë këtë deklaratë.

---

<sup>4</sup> Kjo deklarate ka si qellim plotesimin e kriterit ligjor qe operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent

## Shtojca 12

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Preventivin e Punimeve, sipas Shtojcës Extra;
- c. Grafikun e Punimeve, sipas shtojces Extra;
- d. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;
- e. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- f. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 7;
- g. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 8/1;
- h. Formular vlerësimi, sipas Shtojcës 9;
- i. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve, sipas Shtojcës 10;
- j. Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;
- k. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### 2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:
  - a. Operatoret ekonomik pjesëmarres ne kete prokurim duhet qe te plotesojne kapacitet ligjore, teknike dhe profesionale per kryerjen e ketij prokurimi.
  - b. Operatoret ekonomike duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen shoqerise, sipas formatit te miratuar me VKM
  - c. Licensa profesionale e Operatoreve Ekonomik e lidhur me ekzekutimin e punes te kontrates objekt prokurimi, duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

Nr.	Kategoria	Klasifikimi	Emertimi i kategorise
1.	NP - 1	A	Punime germimi ne toke
2.	NP - 4	A	Rruge, autostrada, mbikalime.....
3.	NP - 7	A	Ujesjellsa, Gazsjellsa, Vajsjellsa
4.	NP - 12	A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.
5.	NS - 7	A	Barriera dhe mbrojtje rrugore
6.	NS - 6	A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese
7.	NS - 9	A	Punime strukturore speciale
8.	NS - 10	A	Shtresa dhe mbistruktura speciale
9.	NS - 16	A	Ndertim i impinateve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij
10.	NS - 18	A	Punime topogjeodezike
11.	NS - 20	A	Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje

Ne rastin e paraqitjes se ofertave nga nje bashkim i operatoreve ekonomik, duhet te plotesohen kerkesat e percaktuara ne nenin 74 te VKM Nr.914 date 29.12.2014 (i ndryshuar).

- Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (njehsimin ) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë.
- Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike, licensat profesionale duhet qe t'i paraqes OE qe ka marre persiper punimet per te cilat kerkohet pika e licenses perkatese.



### 3. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- **Kopje te deklaratave te xhiros vjetore** te realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit (2017, 2018 dhe 2019) vlera mesatare e se cilave, te jete jo më e vogël se 50 % e vleres se fondit limit që prokurohet.
- **Kopje e vertetuar te bilanceve** te tre viteve te fundit (2017, 2018 dhe 2019) te paraqitur prane Administrates Tatimore, te konfirmuar nga ky autoritet.
- **Vertetim për shlyerjen e taksave vendore** te parashikuara nga Pushteti Vendor per vitin 2020

### 4. Për kapacitetin teknik:

*(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)*

#### 4.1.Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit (2017 - 2018 – 2019).
- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit (2017 - 2018 – 2019), është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

*(Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme).*

-Autoriteti Kontraktor (AK), si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve

**Si dëshmi per pervojen e meparshme kerkohen te paraqitet “Shtojca 9” e shoqeruar me:**

- Kontraten e punimeve;
- Aktin e kolaudimit;
- Situacionin perfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
- Faturat tatimore per çdo situacion punimesh;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

**Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar ne sektorin privat kerkohen te paraqitet “Shtojca 9” e shoqeruar me:**

- Formularin e vleresimit;
- Kontrate;
- Lejen e ndertimit;
- Situacionin perfundimtar;
- Akt kolaudimi objekti;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim te objektit;
- Fatura tatimore per cdo situacion punimesh;

**4.2. Një punësim mesatar i të paktën 180 (njqind e tetetehjete) punonjesve per periudhen Gusht 2020 - Janar 2021, te vërtetuar me;**

- Kjo te deshmohet me vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore per numrin e punonjesve te siguruar (Formulari E-SIG 02/a) dhe te shoqerohet me **Listepagesat e Kontributeve te Sigurimeve Shoqerore** formularet **E-SIG 025/a**.

**4.3. Operatoret Ekonomik duhet te kete si pjese te stafit te tij te punes si drejtues teknik, per periudhen e kerkuar sa me siper:**

- Inxhinier Ndertimi 1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)
- Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi 1 (nje)
- Inxhinier Mekanik 1 (nje)
- Inxhinier Gjeolog /Hidrogeolog 1 (nje)

a).Per stafin inxhinierik, duhet detyrimisht per periudhen e mesiperme te jene te pasqyruar ne liste-pagesat e operatoreve ekonomik. OE duhet te paraqese kontrate noteriale pune (*me kohe te plote*) me afat vlefshmerie brenda afatit te zbatimit te punimeve per kete objekt, CV, si dhe diplomat profesionale te tyre.

b) Pervecese stafit te mesiperm per te realizuar punimet e parashikuara ne projekt OE duhet te kete te punesuar nje staf mbeshtetes si me poshte vijon:

- Inxhinier Ndertimi (profili Strukturist) 4 (kater)
- Inxhinier Ndertimi (profili Transport) 1 (nje)
- Inxhinier Ndertimi (profili Gjeoteknik) 1 (nje)
- Inxhinier Ndertimi (master Menaxhim Projektesh) 1 (nje)
- Inxhinier Gjeoburimesh/Gjeoinxhinieri 1 (nje)
- Inxhinier Mjedisi (profili Energjitike) 1 (nje)

c).Operatori Ekonomik duhet qe te percaktoje me ane te nje Deklarate, (*nga administratori i shoqerise*) Drejtuesin Teknik te punimeve ne objekt si dhe te deklarroje se ai do te jete i pranishem gjate gjithë kohes qe do te realizohen punimet ne objekt, te shoqeruar me dokumentacionin e meposhtem:

- Kontrate pune e vlefshme;
- Diplome profesionale;

**4.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë të paktën 50 punonjës të çertifikuar me deshmi te sigurimit teknik, te lëshuar nga DPA ose Trupa çertifikuese ekuivalente, në përputhje me zërat e punimeve në preventiv. Brenda kesaj liste duhet te deshmoje, dhe te figurojne ne liste-pagesat e shoqerise per 12 muajt e fundit, pozicionet e meposhtme:**

- 1 (nje) Hidraulik** te vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Çertifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit profesional lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jopublike, të akredituara, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- 4 (kater) Specialistë për montim/saldim tubash (HDPE)**, shoqëruar me çertifikatat dhe dëshmitë përkatëse;
- 1 (nje) Specialist** për testimin e tubove nën presion (HDPE);

- d. **1 (nje) Elektriçist**, te vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Çertifikatë/dëshmi/diploma përkatëse të kualifikimit profesional të lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jo publike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- e. **3 (tre) Teknik Ndërtimi**, te vërtetuar me kontratë pune të vlefshme si edhe të pajisur me Certifikatë /dëshmi /diploma përkatëse të kualifikimit profesional të lëshuar nga shkolla të mesme profesionale ose institucione jopublike, të akredituara në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- f. **9 (nente) Manovratorë të mjeteve të rënda**, te vërtetuar me kontratë pune e cila duhet të jetë e vlefshme, dhe me Dëshmi Aftësimi Profesional të vlefshme;
- g. **5 (pese) shoferë**, vërtetuar me kontratë pune e cila duhet të jetë e vlefshme, dhe me Dëshmi Aftësimi Profesional të vlefshme;

**4.5.** Operatori Ekonomik duhet të ketë në përbërje të stafit, në përputhje të plote me kërkesat e percaktuara në VKM Nr.632, datë 15.07.2015, i ndryshuar si dhe VKM Nr.108, datë 09.02.2011, i ndryshuar, 1 (nje) Mjek.

- Per këtë pozicion pune Operatori Ekonomik duhet të paraqesë, kontratë pune të vlefshme, diplome CV, leje ushtrimi profesioni të lëshuar nga Urdheri i Mjekut

**4.6.** Operatori ekonomik të ketë Liçensë për Mbrojtjen nga Zjarri të lëshuar nga QKL.Kodi 1.2.A.

- Operatori ekonomik duhet të ketë si pjesë të stafit të punësuar **1(një) Ekspert zjarrëfikës**, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme dhe të pajisur me Liçensë për Mbrojtjen nga Zjarri të lëshuar nga QKL

**4.7.** Operatori ekonomik, duhet të ketë Liçensë për Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor ndikim në mjedis) Kodi III.2.A (1+2).

- Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë si pjesë të stafit të punësuar, ose të kontraktuar të paktën **1(një)Ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis**, të vërtetuar me kontratë noteriale pune (të vlefshme) dhe të pajisur me Çertifikatën përkatëse.

**4.8.** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Liçensë profesionale, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me Kod III.2.B, për Grumbullim dhe Transport të mbetjeve jo të rrezikshme.

**4.9.** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, personel të kualifikuar/ certifikuar si:

- **1 (një) punonjes** të pajisur me çertifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëritë akredituara ose nga organizma ndërkombëtar akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- **1 (një) punonjës** të pajisur me certificate si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me kërkesat e ligjit Nr.10 327, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- **1 (një) punonjes** si "Përgjegjës për dëmet në mjedis", gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin Nr.10 431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (i ndryshuar).

**5.** Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin çertifikatën të lëshuar nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë:

- Çertifikatën ISO 9001 – 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë).
- Çertifikatën ISO 14001 – 2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit).
- Çertifikatën ISO 45001 – 2018 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit e sigurisë në punë).

- Çertifikatën ISO PAS 99 – 2012 (Sistemi i menaxhimit të integruar)
- Çertifikatën ISO 39001 – 2012 (Sistemi i menaxhimit të sigurise ne trafikun rrugor)
- EN –ISO 3834-2 : 2006 (Çertifikate per sistemin e menaxhimittecalesise ne saldim)
- SA 8000: 2014 (Per menaxhimin e Pergjegjesise Sociale)
- ISO/ICE 27001:2013 (Per menaxhimin e Sigurise se Informacionit)
- ISO 39001: 2012 (Çertifikate per sistemin menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor)
- ISO 50001:2018 (Çertifikate Per Sistemin e Menaxhimit te Energjise

***Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Çertifikuar sipas standarteve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.***

6.Operatori ekonomik duhet te paraqese Autorizim Prodhuesi/distributori, per katalogjet ose fragmente te katalogjeve (shoqëruar me çertifikatë ISO 9001:2015 të prodhuesit të mallit) per:

- Tubat plastike perkates pjese e preventivit
- Tubat e çelikut perkates pjese e preventivit
- Rakorderi/saracineska pjese e preventivit
- Matesa e ujit, sipas specifikimeve teknike te preventivit

**a).Autorizim të prodhuesit/ve ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) të zyrtarizuar,** e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave lëshuar/ lidhur jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi/ Marrëveshja bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**b).Katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve** për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

- **Shënim:** *Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*

**c).Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera,** të lëshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e materialeve të prodhuara (lista e mësipërme) me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

**d).Të gjitha materialet duhet të jenë sipas standarteve Europiane si dhe të prodhuara nga prodhues të çertifikuar me ISO - 9001 dhe/ose të pajisur me Çertifikatë konformiteti për produktet e kërkuara.**

7.Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik (**shtojca 10**).

**a).**Ne funksion te zbatimit te kontrates, kerkohet te jene ne dispozicion keto mjete/makineri dhe pajisje pune:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Gjendja Juridike
1.	Kamion vetëshkarkues, me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton	Copë	5	Në pronësi ose me qera
2.	Kamionçine vetëshkarkuese me kapacitet minimalisht 3 ton	Copë	3	Në pronësi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit

3.	Kamion me vinç	Cope	2	Në pronësi ose me qera
4.	Eskavator me kove para dhe kove mbrapa	Copë	4	Në pronësi ose me qera
5.	Grejder	Copë	1	Në pronësi ose me qera
6.	Eskavator me zinxhire	Cope	5	Në pronësi ose me qera
7.	Eskavator me zinxhir me krahe mbi 18 m	Cope	2	Në pronësi ose me qera
8.	Minieskavator	Cope	3	Në pronësi ose me qera
9.	Kamionçinë me kapacitet mbajtes jo me shume se 1 Ton	Copë	4	Në pronësi ose me qera
10.	Autobitumatriçe	Copë	1	Nëpronësiose me qera
11.	Asfalto-shtrues	Copë	1	Nëpronësiose me qera
12.	Rrul gome – hekur (kapaciteti jo më pak se 6 ton)	Copë	2	Nëpronësiose me qera
13.	Rrul hekur – hekur (kapaciteti jo mëpak se 3 ton)	Copë	3	Nëpronësiose me qera
14.	Rrul kompaktor ngjeshes	Cope	2	Në pronësi ose me qera
15.	Autobetoniere	Copë	4	Në pronësi ose me qera
16.	Gurrëthyes, frontoje	Copë	1	Në pronësi ose me qera
17.	Rimorkiator	Copë	2	Në pronësi ose me qera
18.	Koke terheqese	Copë	2	Në pronësi ose me qera
19.	Autofshese	Copë	1	Në pronësi ose me qera
20.	Wellpoint	Copë	1	Në pronësi ose me qera
21.	Makineri vijezi	Copë	2	Në pronësi ose me qera
22.	Matrapik	Copë	2	Në pronësi ose me qera
23.	Çekiç per thyerje inertesh	Cope	1	Në pronësi ose me qera
24.	Kompresorajri	Copë	2	Në pronësi ose me qera
25.	Moto Gjenerator	Cope	3	Në pronësi ose me qera
26.	Motosaldatriçe	Cope	2	Në pronësi ose me qera
27.	Saldatriçe	Cope	4	Në pronësi ose me qera
28.	Aparature elektronike per kontrollin e presionit, Pompe presioni deri 40 bar per te realizuar proceduren e testeve të presionit sipas standartit EN 805.	Cope	2	Në pronësi ose me qera
29.	Aparat Saldimi me elektrofuzion	Cope	1	Në pronësi ose me qera
30.	Aparat saldimi koke me koke	Cope	1	Në pronësi ose me qera
31.	Aparat Saldimi per ngjitje te tubove PE	Cope	4	Në pronësi ose me qera
32.	Autobot uji	Copë	2	Në pronësi ose me qera
33.	Freze asfalti	Copë	1	Në pronësi ose me qera
34.	Vibrator betoni	Copë	2	Në pronësi ose me qera
35.	GPS	Copë	2	Në pronësi ose me qera
36.	Skeleri dhe armature	m2	1500	Në pronësi ose me qera
37.	Autopompe betoni	Copë	2	Në pronësi ose me qera
38.	Kokore	Copë	160	Në pronësi ose me qera
39.	Jelek	Copë	160	Në pronësi ose me qera
40.	Fikese zjarri	Copë	20	Në pronësi ose me qera

41.	Karroca dore	Copë	10	Në pronësi ose me qera
42.	Tabela sinjalizuese	Copë	20	Në pronësi ose me qera
43.	Autovinc me kosh	Copë	1	Në pronësi ose me qera
44.	Karroca dore	Copë	10	Në pronësi ose me qera
45.	Kulle ndricimi	Cope	1	Në pronësi ose me qera
46.	Pajisje per skanimin e infrastruktures ne tokesore	Copë	1	Në pronësi ose me qera
47.	Prozhektorendriçimi	Copë	8	Në pronësi ose me qera

c. Ne funksion te zbatimit te kontrates OE duhet te paraqese dokumentacionin per

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Gjendja Juridike
1.	Fabrike asfalti e paisur me Leje Mjedisi	Cope	1	Në pronësi, me qera, ose me kontrate furnizimi
2.	Impiant betoni i paisur me Leje Mjedisi	Copë	1	Në pronësi, me qera, ose me kontrate furnizimi
3.	Impiant inertesh i paisur me Leje Mjedisi	Copë	1	Në pronësi, me qera, ose me kontrate furnizimi

- Per mjetet ne pronesi qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (Leja e Qarkullimit, Çertifikata e Kontrollit Teknik, Policën e sigurimit të detyrueshme e mjeteve).
- Per makinerite dhe pajisjet qe nuk shenohen ne regjistrat publike, duhet te paraqitet dokumenti qe verteton pronesine e tyre (fature tatimore/kontrate shitje).
- Per mjetet dhe pajisjet e marra me qera, formularit dhe dokumentave te mesiperme t'i bashkelidhen kontrata perkatese noteriale te qerese.
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar.
- Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. ***(Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).***

(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)

***Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim***

## Shtojca 13

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

### **PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE**

#### **Hyrje**

Qellimi i këtij projekti është përmirësimi i furnizimit me uje të pijshëm dhe eliminimi i abuzimeve me matjen e ujit, si dhe:

- Përmirësimi i furnizimit me uje të pijshëm dhe eliminimi i abuzimeve me matjen e ujit për lagjen industriale të qytetit pasi aktualisht nuk ka matesa dhe furnizimi i banesave bëhet në mënyrë të parregullt nga linajt e vjetra.
- Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe eliminimi i linjave të amortizuara në rrjetin shpërndarës për banesat një dhe dy kateshe në lagjen nr.3 të qytetit, Kukes.
- Rik. i pjesshem i linjes së transmetimit nga burimi Domje e cila aktualisht është e rrezikuar nga rreshqitja.
- Përmirësimin e furnizimit me uje për fshatin Bushat i cili aktualisht ka një mundësi të theksuar të furnizimit me uje, etj.

Fondi për zbatimin e këtij investimi, është akorduar nga AKUM me shkresën Nr.2999 Prot. date 24.11.2020 (e ndryshuar me shkresën Nr.64 Prot. date 06.01.2021). Ky institucioni ka miratuar fondin për realizimin e këtij investimi, si dhe mënyrën e alokimit të tij në shumën 254.991.756 leke (Pa TVSH) për periudhën buxhetore 2021 – 2023

Gjithashtu projekti i zbatimit, konform kërkesave të përcaktuara në VKM Nr.1055, date 22.12.2010 është miratuar nga Instituti i Ndertimit, i cili është shprehur për opionencën teknike të tij.

**Përshkrimi i të dhënave teknike të punëve objekt prokurimi** të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

■ Skicimet, Planimetritë e Objektit etj:

*Bashkëngjitur dokumentave standarte të tenderit*

■ Specifikimet Teknike të Materialeve:

*Bashkëngjitur dokumentave standarte të tenderit*

■ Grafiku i Punimeve:

*Bashkëngjitur dokumentave standarte të tenderit*

**Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

- Kontraktori do sigurojë një program dhe metodikë punimesh për të kryer punimet e ndertimit sipas kërkesave teknike të zbatimit.
- Kontraktori merr përsipër të mbrojë ambientin dhe të drejtojë aktivitetin e tij të përditshëm në një mënyrë ekologjiksht përgjegjëse dhe të ndalojë apo pakësojë në minimum efekte të mundshme ambientale negative.

**Per detaje me te veçanta teknike do te jepen ne kontraten e sipermarrjes qe do te nenshkruhet me subjektin fitues te procedures se prokurimit.**

**KUJDES !**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

**Shtojca 14**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)*

**PREVENTIVI I PUNIMEVE**

Preventivi i punimeve bashkangjitur DST- se.

**Shenim:**

- Çmimet duhet të jënë të shprehura në leke
- Ky formular duhet të bashkangjitet si dokument i veçantë, shtojcës Nr.1



## Shtojca 15

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>5</sup>

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< **Emri** >

---

<sup>5</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

## Shtojca 16

[ Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data\_\_\_\_\_]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

2. \_\_\_\_\_  
Emri i plotë i shoqërisë numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

## Shtojca 17

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

## Shtojca 18

### **KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur**

#### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

#### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit” do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhënia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punon objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.

- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

### **Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 5: Informacioni Konfidencial**

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

### **Neni 6: Prona Intelektuale**

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t’i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t’i përdori për qëllime që s’kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.



- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### **Neni 7: Origjina e Materialeve**

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

#### **Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

#### **Neni 9: Komunikimi**

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

#### **Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

#### **Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

### **Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

### **Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

### **Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

### **Neni 15: Ngritja e Kantierit**

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

### **Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

